

# UDHËZUES

rreth

Kritereve të Vëzhgimit me Kamera në  
Institucionet Arsimore



*Ky udhëzues është hartuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe i dedikohet institucioneve arsimore të të gjitha niveleve, të cilat aplikojnë sistemin e vëzhgimit me kamera në objektet e tyre.*

*Në mbështetje të nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës; Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës; Ligjit Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, në harmoni me nenin 17, nenit 18 (paragrafi 1. nënparagrafi 1.6) të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nxjerrin këtë Udhëzues rreth Kritereve të Mbikëqyrjes me Kamera në Institucionet Arsimore.*



## UDHËZUES

### Kriteret e Vëzhgimit me Kamera në Institucionet Arsimore

Prishtinë, maj 2015

#### Qëllimi

Institucionet e arsimit sot po tregojnë përkushtimin e tyre maksimal në krijimin e kushteve, të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies (ku hyn edhe krijimi i hapësirave të përshtatshme dhe të sigurta) për të gjitha nivelet e arsimit, duke integruar praktikat më të mira të sigurisë përmes teknologjisë. Ky udhëzues adreson nevojat e sigurisë së institucioneve arsimore, duke respektuar dhe ruajtur privatësinë individuale.



Për të siguruar mbrojtjen e të drejtës për privatësi individuale në pajtim me parimet dhe vlerat thelbësore të institucioneve arsimore dhe të shtetit, si dhe të ligjeve në fuqi, ky dokument i brendshëm është hartuar për të formalizuar procedurat për instalimin e pajisjeve të vëzhgimit dhe përdorimin e tyre, përmes të cilave sigurojmë mbikëqyrjen, ruajtjen, publikimin, dhe asgjësimin e të dhënave të vëzhgimit. Përmes përcaktimit të këtyre kriterëve rregullohet çështja e përdorimit të sistemit të kamerave që shfrytëzohen për vëzhgimin dhe inçizimin e hapësirave të institucioneve arsimore për qëllime sigurie. Publikimi i këtij dokumenti të karakterit udhëzues nuk nënkupton apo garanton monitorimin e kamerave përgjatë 24 orëve brenda ditës, shtatë ditë në javë. Sot, institucionet arsimore mbështesin dhe aplikojnë përdorimin e video kamerave brenda hapësirës së edukimit, mësimnxënies dhe kampuseve (duke përfshirë këtu edhe konviktet) si mjete të monitorimit dhe mirëmbajtjes së kampuseve të sigurta për nxënësit, studentët, punonjësit dhe vizitorët.



## Linjëveprimi

Institucionet arsimore, në kuadër të një zyreje përgjegjëse për teknologji informative (TI), kanë autoritet për të përzgjedhur, kontraktuar, bashkërenduar, operuar, menaxhuar, dhe monitoruar të gjitha sistemet e vëzhgimit të sigurisë së hapësirave të mësimnxënies, studimit, ambienteve akomoduese (konvikteve) brenda kampuseve të tyre. Zyra/personi i ngarkuar duhet të jetë përgjegjës për aplikimin e duhur e të përgjegjshëm të teknologjisë për vëzhgim me kamera dhe për ofrimin e ndihmës teknike brenda institucionit (duke përgatitur propozime për blerjen dhe instalimin e sistemeve të kamerave të sigurisë).

Këto zyra/persona përcjellin zhvillimet legjislative dhe teknologjike për t'u siguruar që vëzhgimi me kamera po aplikohet në përputhje me praktikën më të mira dhe se është në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës.



Do të duhej të bëhej praktikë që institucionet arsimore të rishikojnë propozimet dhe rekomandimet për instalimin e kamerave, si dhe të rishikojnë pozicionet specifike për kamera për të përcaktuar që perimetri i pamjes së kamerave të jetë në përputhje me këtë udhëzues.

Të dhënat e regjistruara nga sistemi i vëzhgimit me kamera brenda hapësirave të institucioneve arsimore nuk emetohen (publikohen) në publik, para studentëve dhe punonjësve të institucionit arsimor. Përmbajtja e materialit inçizuar është e dhënë personale e nxënësve / studentëve të institucionit përkatës arsimor, që i nënshtrohet udhëzimeve apo rregulloreve për sa i përket të dhënave të nxënësve / studentëve. Në të shumtën e rasteve, vetëm personat, pozita e të cilëve e arsyeton veprimin apo ata që kanë arsye që lidhen me gjendjen e sigurisë, mund të kenë qasje në të dhënat e ruajtura nga vëzhgimi me kamerë. Përjashtim në kërkesën për të pasur qasje në këto pamje bëjnë personat që janë subjekt i të dhënave të ruajtura apo që qasja e tyre i shërben qëllimit të hetimit të lidhur me një veprë të caktuar penale, shkeljes së kodit të etikës, një çështjeje të rëndësishme të sigurisë së institucionit arsimor ose shkeljes së rregullave përkatëse. Në rastin e institucioneve edukative/parashkollore këtë qasje mund ta kenë prindërit e fëmijëve të cilët paraprakisht kanë dhënë pëlqimin e tyre për aplikimin e vëzhgimit me kamera në hapësirat e institucionit edukativ ku kanë të regjistruar fëmijët e tyre.



## Fushëveprimi

Ky udhëzues aplikohet për tërë personelin e institucioneve arsimore në përdorimin e kamerave të sigurisë dhe në sistemet e monitorimit e video inçizimit të tyre. Kameran e sigurisë mund të instalohen në pozicione dhe vende ku mund të shtohet siguria, qoftë e pronës apo e personave. Fushëpamja e kamerave të pozicionuara duhet kufizuar që të mos shkelin pritjet e arsyeshme të privatësisë siç përcaktohet me ligj. Në rastet kur dëshmohet e përshtatshme, kamerat mund të vendosen nëpër tërë institucionin arsimor, brenda dhe jashtë objekteve. Megjithëse pajisjet fizike të kamerave mund të jenë të ngjashme, funksionet e këtyre kamerave bien në tri kategori kryesore:

A. Mbrojtja e Pronës: Në rastet kur synimi kryesor është të kapen pamje dhe të ruhen në pajisje që vepron nga distanca, në mënyrë që nëse prona raportohet se është vjedhur apo dëmtuar, atëherë pamjet e videos mund të tregojnë autorin e veprës. Shembull: kabinet kompjuterësh pa personel, laborator shkencor pa personel, ose vendparkim.

B. Siguria Personale: Në rastet kur si qëllim kryesor është kapja e pamjeve dhe ruajtja e tyre në një pajisje të operueshme nga distanca ashtu që kur një person sulmohet, videoja (pamjet e ruajtura) mund ta tregojnë keqbërësin. Shembuj: siguria e personelit arsimor, nxënësve ose studentëve.

## Parimet e Përgjithshme

Të dhënat e marra nga kamerat shfrytëzohen ekskluzivisht për zbatimin e linjëveprimit të institucionit arsimor, respektivisht objekteve primare dhe përcjellëse arsimore. Të dhënat duhen trajtuar me nivelin e duhur të sigurisë për t'i mbrojtur nga qasja e paautorizuar, tjetërsimi apo publikimi.

Duhen marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur të drejtën e individit për privatësi dhe për të mbajtur informacionet e institucionit të sigurt në periudhën e krijimit, ruajtjes, transmetimit, përdorimit dhe fshirjes.

Çdo instalim i kamerave i nënshtrohet ligjeve përkatëse shtetërore, në veçanti Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sektorët e caktuar të sistemit arsimor të cilitdo nivel që kërkojnë kamera të sigurisë duhen ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë udhëzues.

## Vendosja e Kamerave

Vendet (pozicionet) ku instalohen kamerat mund të jenë hapësira me qasje të kufizuar, si kabinetet e kompjuterëve; megjithëkëtë, këto hapësira nuk janë vende ku individit ka pritje të arsyeshme të privatësisë. Kamerat duhen pozicionuar në atë mënyrë që privatësia personale të jetë e nivelit maksimal.





Zëri i pamjeve nuk regjistrohet. Pozicionet e kamerave dhe pamjet e ambienteve të banimit (siç mund të jetë rasti i konvikteve) kufizohet. Pamja e ambientit banues nuk duhet të shkelë standardin e pritjes së arsyeshme të privatësisë.

Përveç rasteve kur kamerat shfrytëzohen për qëllime hetimi, ndalohet monitorimi nga kamerat e sigurisë në vendet si në vijim:

- Nevojëtoret / WC-të
- Dhomat e konvikteve
- Zhveshtoret
- Mësojtoret që nuk shfrytëzohen si laboratorë/kabinete
- Ashensorët
- Kuzhinat (në kampuse ose institucione parashkollore)



Mësojtoret e institucioneve parashkollore mund të përbëjnë përjashtim në rastet kur në vendimin e marrë nga menaxhmenti theksohet arsyeja dhe paraprakisht merret pëlqimi i prindërve. Këto

institucione duhet të sigurojnë hapësira (mësojtore) ku nuk aplikohet vëzhgimi me kamerë për fëmijët, prindërit e të cilëve nuk japin pëlqimin për vëzhgim.

Instalimi i kamerave “maketë” që nuk janë funksionale mund të aplikohet aty ku shihet e arsyeshme për të arritur efekte psikologjike sigurie.

Përveç në rastet kur shfrytëzohen për qëllime hetimi nga autoritetet kompetente, të gjitha instalimet e video kamerave duhen të jenë të dukshme si dhe të kenë të vendosur shenja paralajmëruese.

Lokacioni i saktë, numri dhe funksioni i të gjitha kamerave në përgjithësi konsiderohet si konfidencial për qëllime sigurie dhe nuk ndahet me publikun e përgjithshëm, nëpunësit apo vizitorët.



### Qasja dhe Monitorimi

Të gjitha regjistrimet (pamjet e inçizuara) apo monitorimi i aktiviteteve të individëve apo grupeve nga kamerat e sigurisë së institucionit arsimor bëhen në përputhje me rregullat e brendshme të institucionit arsimor dhe ligjet përkatëse. I tërë regjistrimi apo monitorimi

bëhet në mënyrë profesionale, etike dhe të ligjshme.

I tërë personeli me qasje në kamerat e sigurisë të institucionit arsimor duhet trajnuar rreth përdorimit efektiv, të ligjshëm dhe etik të pajisjes së monitorimit.



Kamerat e sigurisë së institucioneve arsimore në përgjithësi nuk monitorohen në vazhdimësi në kushte normale të operimit, por mund të monitorohen për qëllime legjitimiteti dhe të sigurisë që përfshijnë, por nuk kufizohen në: hapësira me rrezikshmëri të lartë, hapësira/lokacione me qasje të kufizuara, në përgjigje të alarmit, ngjarjeve të veçanta, qëllime

mirëmbajtjeje, qëllime funksionimi dhe hetime specifike të autorizuara nga zyrtari përgjegjës i institucionit që aplikon vëzhgimin me kamerë.

Në rastet e raportimit të ndonjë incidenti, personeli përgjegjës i hapësirës mund të kërkojë nga një zyrë përkatëse që mund të ekzistojë në institucionin arsimor që monitoron kushtet e zhvillimit të procesit arsimor apo kushtet e banimit që të shikojë pamjet e regjistruara me kamera. Varësisht prej rrethanave, zyrtari më i lartë i institucionit arsimor mund të autorizojë dikë tjetër për t'i shikuar këto pamje. Është praktikë e përshtatshme të mbahet një ditar shënimesh për të gjitha nivelet e qasjes në materialet e regjistruara me kamera.

### Përdorimi i Duhur dhe Konfidencialiteti

Personelit i ndalohet përdorimi apo shpërndarja e informacionit të marrë nga kamerat e sigurisë të institucioneve arsimore, përveç rasteve kur shfrytëzohen për qëllime zyrtare. Të gjitha informacionet dhe vërejtjet e bëra në përdorimin e kamerave të sigurisë konsiderohen konfidenciale dhe mund të shfrytëzohen vetëm për qëllime zyrtare të institucionit arsimor dhe institucioneve të zbatimit të ligjit me miratimin e zyrtarit më të lartë të institucionit arsimor. Nga personeli pritet të respektojnë dhe ndjekin kriteret e këtij udhëzuesi.

### Përfshirjet

Ky udhëzues nuk aplikohet ndaj kamerave që përdoren për qëllime akademike. Kamerat që përdoren për hulumtime, komunikim, projekte mësimnxënije, etj., mund të rregullohen përmes udhëzimeve tjera që përfshijnë subjektet njerëzore e që përjashtohen nga ky udhëzues.

### Linjëveprimi i Përdorimit të Pranueshëm të Kamerave të Sigurisë

Ky linjëveprim nuk adreson çështjen e përdorimit të kamerave personale nga nxënësit/studentët/punonjësit, siç janë kamerat e instaluar në PC, laptop, iPad etj, pastaj ndaj ngjarjeve të cilat incizohen me kamerë (me shirit), pasqyrime pamore të ngjarjeve të drejtpërdrejta 'live', si video konferenca etj., të cilat përdoren për nevojat arsimore apo administrative të institucionit arsimor. Ky udhëzues, poashtu nuk aplikohet ndaj pajisjeve të inçizimit të shfaqjeve publike, intervistave, etj. Shembuj të aktiviteteve të kështilla përjashtimore mund të jenë incizimet e ngjarjeve atletike për t'u parë pas përfundimit të tyre; incizimi i koncerteve, shfaqjeve teatrore, ligjeratave, intervistave të incizuara të personave, etj. Bankomatët (ATM) që mund të jenë të instaluar brenda kampuseve universitare, të cilët mund të kenë të instaluar kamerë, gjithashtu nuk kanë nevojë t'i nënshtrohen rregullave të këtij udhëzuesi.




## Instalimi

Institucionet parashkollore, shkollat, kolegjet, programet, ose kampuset që instalojnë pajisje të vëzhgimit me kamera paraqesin kërkesë me shkrim të zyrtari më i lartë i institucionit arsimor, duke përshkruar lokacionin e propozuar të mjeteve të mbikëqyrjes, si dhe duke e arsyetuar instalimin e propozuar (i cili duhet t'i përmbushë kriteret e sigurisë së individit dhe pronës), pastaj duke paraqitur vlerësimin e kostos së këtij instalimi, dhe duke identifikuar burimin financiar për blerjen dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme. Përkitazi me nevojën e vlerësuar, zyrtari më i lartë i institucionit arsimor nxjerr vendim lidhur me

kërkesën e paraqitur, i cili duhet të jetë në pajtim me këtë udhëzues, respektivisht në harmoni me nënkreun J (nenin 61/62/63/64) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Personi përgjegjës për teknologji informative i institucionit arsimor mbikëqyrë instalimin e të gjitha kamerave të miratuara të sigurisë.



## Trajnimi

Operatorët e kontrollimit të kamerave trajnohen për parametrat teknikë, ligjorë dhe etikë rreth përdorimit të duhur të kamerave. Operatorët e kontrollimit të kamerave duhet ta kenë një kopje të këtij dokumenti dhe të bëjnë pranimin me shkrim që e kanë marrë, lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e tij.

## Operimi

Vëzhgimi me kamera bëhet në pajtim me të gjitha rregulloret e brendshme të institucionit arsimor përkatës. Operatorët e kontrollimit të kamerave bëjnë monitorime bazuar në sjellje të dyshimta, jo në bazë të karakteristikave individuale. Operatorët e kontrollimit të kamerave nuk duhet të shikojnë pamjet e hapësirave private ose ambientet mëtanë dritareve. Të gjithë operatorët dhe mbikëqyrësit e përfshirë në vëzhgim me kamera i kryejnë detyrat e tyre në pajtim me këtë udhëzues. Keqpërdorimi i linjëveprimeve standarde të operimit apo operimet e papërshtatshme të kontrollit të kamerave rezultojnë me ndëshkim dicitlinor.

## Ruajtja e të Dhënave të Regjistruara (Inçizuara)

Nuk lejohet ndryshimi i cilësdo pjesë të të dhënave të regjistruara (inçizuara) nga vëzhgimi me kamerë. Zyrtat e mbikëqyrjes dhe monitorimit konfigurohen për të parandaluar operatorët e kamerave nga ndërhyrja në të dhënat e regjistruara apo nga duplikimi i të dhënave të regjistruara.







Të gjitha të dhënat e regjistruara nga vëzhgimi me kamerë ruhen në vend të sigurtë për një periudhë deri në 6 muaj përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime dhe pastaj fshihen apo të dhëna të reja regjistrohen mbi të dhënat që i nënshtrohen fshirjes.

Për të gjitha nivelet e qasjes në të dhënat e regjistruara nga vëzhgimi me kamera mbahet një regjistër. Ky regjistër përmbanë datën dhe të dhënat identifikuese të personit apo personave të cilit/cilëve i/u është dhënë qasje.



*Për të siguruar shenjë paralajmëruese mbi instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamera, vizitoni web faqen zyrtare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ([www.amdp-rks.org](http://www.amdp-rks.org)).*

*Linku i shenjës paralajmëruese:*

[http://www.amdp-rks.org/web/repository/docs/Shenja\\_Paralajmeruese\\_per\\_Kamere\\_27-07-12.pdf](http://www.amdp-rks.org/web/repository/docs/Shenja_Paralajmeruese_per_Kamere_27-07-12.pdf)